

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
ZYRA E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT TE NXENËSIT
440 NORTH BROAD STREET, SUITE 111
PHILADELPHIA, PA 19130

Danielle N. Seward
Zëvendës Kryetar

Tel. 215-400-4290
Fax: 215-400-4291

Shkolla Fillore “Penn Alexander”
Proçesi i Regjistrimit për në Kopësht -2019

Më poshtë janë drejtimet dhe afatet se si do të zhvillohet proçesi i aplikimit dhe përzgjedhjes për regjistrimin e nxënësve në klasat e kopështit në shkollën fillore “Penn Alexander” (PAS) për vitin shkollor 2019-2020.

Afatet e Proçesit të Lotarisë në Kopështin e Shkollës “Penn Alexander”	
Datat e Regjistrimit	Nga e Martë 22 Janar 2019 deri të Premten 8 Shkurt 2019
Personeli i shkollës dërgon me email listën përfundimtare në OSEP.	13 Shkurt
Drejtoria Arsimore proçeson aplikimet	14-15 Shkurt
Letrat e lotarisë postohen në shtëpitë e nxënësve:	Nga dita e Premte datë 22 Shkurt

Udhëzime të Përgjithëshme

- Lotaria është e vlefshme vetëm për fëmijët me banim në zonën e shkollës “Penn Alexander” (PAS). Të gjitha aplikimet që do të merren pas datës 8 Shkurt 2019, do të vendosen në listën e pritjes. Bashkë me materialet e regjistrimit kërkohen dy prova të banimit në zonën e shkollës. Këto prova të banimit do të kërkohen edhe në kohën e fillimit të shkollës.
- Zyra e Edukimit të Fëmijëve do të hartojë dhe do të dorëzojë në shkollë një listë të nxënësve të “Head Start”, që banojnë në zonën e shkollës “Penn Alexander”. Zyra e Edukimit të Fëmijëve gjithashtu do të njoftojë qendrat e saj në lidhje me afatet e regjistrimit në kopështin e PAS.
- Zyra e Shërbimeve të Specializuara do të hartojë dhe do të dorëzojë një listë të nxënësve që kërkojnë Ndërhyrje të Herëshme, që përfshihen në zonën e shkollës Penn Alexander. Zyra e Shërbimeve të Specializuara gjithashtu do të njoftojë qendrat e saj në lidhje me afatet e regjistrimit në kopështin e PAS.
- Materialet e regjistrimit të “Head Start” dhe Ndërhyrjes së Herëshme, duhet të merren në afatet e kërkuara për regjistrim. Të gjitha aplikimet që do të merren pas datës 8 Shkurt 2019, do të vendosen në listën e pritjes. Bashkë me materialet e regjistrimit kërkohen dy prova të banimit në zonën e shkollës.
- Ky njoftim do të rishikohet çdo vit dhe do të postohet në Uebfaqin e Drejtorisë Arsimore, në kohën kur Drejtoria Arsimore të shpallë regjistrimet në Kopësht, deri në datën 1 Dhjetor. Të gjitha njoftimet do të përkthehen në tetë gjuhët më të folura të Drejtorisë Arsimore.
- Të gjitha materialet e regjistrimit duhet të jenë në PAS në datën e caktuar, në orët 8:00 a.m. -3:00 p.m.
- Të gjitha vendimet e pranimit do të komunikohen vetëm me shkrim, në adresën e shtëpisë së nxënësit. Vendimet e pranimit nuk do të komunikohen me telefon, si edhe nuk do të jepen letra pranimi për prindërit që vijnë në Zyrën e Regjistrimit dhe Pranimit të Nxënësve.

Përditësuar më Tetor, 2018